VENDIM
Nr. 47, datë 22.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 3.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Neritan Tabaku

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 5, datë 12.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 30, 42, 131/f, 134/1/g, 134/2 dhe 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksio-nimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet e administruara në gjykim rezulton se në fund të vitit 2009 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*KLD*) ka kryer kontroll në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën kohore 1.1.2009 dhe në vazhdim.

2. Në datën 8.3.2010 i është paraqitur KLD-së relacioni përkatës i inspektimit, sipas të cilit është konsideruar shkelje e disiplinës në punë mosdo-rëzimi i 60 dosjeve gjyqësore për shkak të mos-arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore, midis të cilave dhe dosja që i përkiste të gjykuarit I. Xh., relator i së cilës ishte gjyqtari Neritan Tabaku (kërkuesi).

3. Në datën 13.9.2012, në vendin e quajtur Katund i Ri, u vra shtetasi A.T. dhe personi i akuzuar për këtë vepër ishte shtetasi I.Xh. Në datën 19.9.2012 inspektorë të KLD-ja, pas verifikimeve të kryera, hartuan relacionin përkatës, duke rekomanduar fillimin e procedimit disiplinor për kërkuesin.

4. Me vendimin nr. 295/1, datë 5.10.2012 KLD-ja ka vendosur: “Miratimin e ndjekjes penale të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës Neritan Tabaku. Pezullimin e tij nga detyra e gjyqtarit derisa vendimi të marrë formë të prerë.”.

5. Me kërkesën nr. 6127/16, datë 26.10.2012, ministri i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra të gjyqtarit Neritan Tabaku”.

6. Me vendimin nr. 301/2, datë 7.12.2012 KLD-ja ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Neritan Tabaku për sjellje që diskre-ditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.”.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës.

8. Me vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë rrëzuar ankimin e kërkuesit Neritan Tabaku.

II

9. *Kërkuesi Neritan Tabaku* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këto shkaqe:

9.1 Është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve e kontradiktoritetit në procedimin disiplinor. Procedimi disiplinor është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, edhe pse në mbledhjen e datës 7.12.2012 mbrojtësi i caktuar prej tij ka kërkuar shtyrjen, pasi kërkuesi ishte në pamundësi të paraqitej personalisht, sepse ishte i sëmurë, i shtruar në urgjencën e spitalit dhe ai nuk kishte tagra përfaqësimi për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor. Ishte detyrë e KLD-së të evidentonte dhe argumentonte shkakun e mosparaqitjes së kërkuesit dhe për sa kohë që ai ishte i ligjshëm dhe i arsyeshëm, nuk mund të zhvillonte seancën dhe të merrte masën e shkarkimit pa i krijuar mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të zbatuar rregullat e kontra-diktoritetit në gjykim. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Gjykata e Lartë, së cilës edhe pse iu paraqit si provë një vërtetim i datës 3.12.2013 se kërkuesi ka qenë i shtruar pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal Durrës, nuk e mori atë parasysh.

9.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike për shkak të parashkrimit të procedimit disiplinor. Për sa kohë që për të gjitha shkeljet e konstatuara në relacionin e datës 8.3.2010 nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim, qartazi ato nuk mund të bëheshin më objekt kontrolli. KLD-ja në tejkalim të kompetencave të saj ka marrë në shqyrtim dhe ka konsideruar si shkelje veprime që ishin parashkruar dhe për të cilat nuk mund të vihej më në lëvizje procedimi disiplinor. Në respekt të parimit të sigurisë juridike ligji ka parashikuar disa afate me qëllim mbrojtjen e gjyqtarit dhe mosabuzimin me të nga organet e veshura me pushtet shtetëror. Procedimi i kërkuesit për shkelje të kryera në një periudhë prej më shumë se 2 vjetësh është në kundërshtim me nenin 34 të ligjit nr. 9877/2008 dhe bie ndesh me parimet e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike.

9.3 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë në procedimin disiplinor, pasi kjo çështje është paragjykuar. Gjykimi administrativ jo vetëm është bërë në mungesë të subjektit në procedim apo të përfaqësuesit të tij (qoftë edhe të një përfaqësuesi të caktuar kryesisht), pa shkaqe të përligjura, por konkluzionin përfu-ndimtar për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit KLD-ja e ka arritur duke u bazuar në fakte dhe rrethana që lidheshin me çështje e shkelje të pretenduara, të cilat nuk mund të merreshin më në shqyrtim për shkak të parashkrimit të tyre dhe nuk është bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete të rezultuara nga gjykimi.

9.4 Është cenuar parimi i pavarësisë, paprek-shmërisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit, i sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës, pasi gjatë procedimit disiplinor nuk është verifikuar asnjë akt ose sjellje që diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit apo cenon në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Kërkesa për procedim dhe vetë vendimi i KLD-së janë haptazi të pabazuara në ligj dhe në fakt. Vonesa për shkaqe të jashtme, të arsyeshme, në arsyetim apo në dorëzimin e një apo disa dosjeve, përjashton dukshëm, qoftë dhe në formën e pretendimeve, elemente të kërkuara për përgjegjësinë disiplinore. Asnjëherë nuk është pretenduar që këto "vonesa" të kenë qenë të qëllimshme dhe asnjëherë nuk është vërtetuar që ato të kenë cenuar të drejta kushtetuese të shtetasve apo palëve në proces. Po ashtu, në kërkesën për procedim dhe relacionet që e shoqërojnë nuk janë pretenduar shkelje në lidhje me realizimin e drejtësisë, si detyrë themelore funksionale e kërkuesit.

9.5 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit dhe nuk ka korrigjuar shkeljet e kryera nga KLD-ja gjatë procedimit administrativ. Vendimi i Gjyka-tës së Lartë është jologjik dhe ka kundërthënie të hapura. Nëse lexohet vendimi në tërësinë e tij Gjykata e Lartë herë konfirmon dhe herë rrëzon fakte të caktuara, shkelje të cilat janë referuar në çdo pretendim tjetër për cenimin e procesit të rregullt. Gjykata e Lartë arrin në përfundime të cilat nuk janë bazuar në provat e administruara në

gjykim dhe që nuk janë rrjedhë logjike e argumenteve të përdorura prej saj.

10. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë***, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka parashtruar:

10.1 Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes rezulton se KLD-ja ka caktuar 3 mbledhje për shqyrtimin e kësaj kërkese, konkretisht në datat 15.11.2012, 30.11.2012 dhe 7.12.2012. Dy mbledhjet e para kanë dështuar dhe janë shtyrë për shkak të paraqitjes së raporteve shëndetësore nga gjyqtari Nertitan Tabaku. Në mbledhjen e datës 7.12.2012 është paraqitur mbrojtësi i zgjedhur me prokurë të posaçme, i cili ka paraqitur kërkesë për pezullimin e procedimit administrativ deri në përfundimin e procedimit penal të gjyqtarit Neritan Tabaku. Kjo kërkesë është rrëzuar nga KLD-ja dhe pas kësaj ai është larguar duke deklaruar se nuk ka tagra përfaqësimi për të vijuar mbrojtjen për themelin e procedimit disiplinor. Në këto rrethana KLD-ja ka vijuar procedimin administrativ dhe pas marrjes së vendimit, ai i është njoftuar gjyqtarit me aktin nr. 2435, datë 28.12.2012.

10.2 Gjyqtari Neritan Tabaku ka marrë njoftim rregullisht mbi të gjitha momentet kyçe të procedimit administrativ disiplinor. Ai është njoftuar me aktin e datës 17.9.2012, nënshkruar personalisht prej tij në prani të dy inspektorëve. Me aktet nr. 6026/2 prot., datë 25.9.2012, nr. 6127/1 prot., datë 4.10.2012 dhe nr. 6026/4 prot., datë 8.10.2012 të Ministrisë së Drejtësisë atij i janë përcjellë rezultatet e verifikimit të Inspektoratit të KLD-së për të dyja procedurat e verifikimit, atë të vitit 2010 dhe atë të vitit 2012. Marrja e njoftimit të rregullt prej tij konfirmohet jo vetëm me aktet e mësipërme, por edhe me kërkesën me shkrim të paraqitur nga vetë gjyqtari dhe të regjistruar në KLD me nr. 2136 prot., datë 30.11.2012, si dhe me dy raportet mjekësore të datave 5.11.2012 dhe 27.11.2012. Gjyqtari Neritan Tabaku është njoftuar rregullisht me vendimin nr. 301/2, datë 7.12.2012 për dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Nga sa më sipër rezulton se gjyqtari Neritan Tabaku ka marrë dijeni për procedimin disiplinor dhe me vullnetin e tij të lirë ka zgjedhur të mos marrë pjesë në të, të mos paraqesë prova mbi faktet dhe të mos dëgjohet personalisht nga KLD-ja. Për pasojë, pretendimi i tij për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e njoftimit, të marrjes pjesë në procedim, të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, janë haptazi të pabazuara.

10.3 Procedimi disiplinor i zhvilluar nga KLD-ja nuk pengohet apo nuk pengon proce-dimin penal në ngarkim të këtij shtetasi dhe as kushtëzohet nga vazhdimësia ose jo e tij apo konkluzionet që mund të dalin nga ky hetim penal. Duke qenë një procedim disiplinor, ku janë marrë në shqyrtim shkeljet administrative të gjyqtarit (dhe jo fajësia e tij për një vepër penale të caktuar, e cila është atribut vetëm e procesit gjyqësor penal), ai është plotësisht në përputhje me Kushtetutën, ligjin organik të KLD-së dhe atë për organizimin e pushtetit gjyqësor. Për pasojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

10.4 Nga analiza e vendimit nr. 301/2, datë 7.12.2012 të KLD-së konstatohet lehtësisht se ai ka përmbushur të gjitha elementet e nevojshme formale të një vendimi të arsyetuar. Ai jep informacion mbi faktet që qëndrojnë në themel të procedimit, mbi procedurën e ndjekur, bën analizën e këtyre fakteve, duke i ballafaquar me legjislacionin e zbatuar, si dhe nxjerr konkluzi-one, duke u bazuar në dokumentacionin shkresor të marrë në shqyrtim nga KLD-ja. Për pasojë, edhe ky pretendim është i pabazuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Repub-likës së Shqipërisë". Po ashtu, kërkuesi legjiti-mohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij në kërkesë janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve të ngritura në kërkesë

12. Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar para saj si procesin administrativ të zhvilluar nga KLD-ja, ashtu edhe atë të zhvilluar nga Gjykata e Lartë. Sipas tij, në procedimin disiplinor është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve, për shkak të zhvillimit të procedimit në mungesë të tij, parimi i sigurisë juridike, për shkak të parashkrimit të procedimit disiplinor, parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi kjo çështje është paragjykuar, parimi i pavarësisë, paprek-shmërisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit, i sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës, për shkak se gjatë procedimit disiplinor nuk është verifikuar asnjë akt ose sjellje që diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit apo cenon në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor, si edhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor të vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili nuk u ka dhënë përgjigje pretë-ndimeve të ngritura prej tij dhe nuk ka korrigjuar shkeljet e kryera nga KLD-ja gjatë procedimit administrativ.

13. Gjykata, gjatë votimit të çështjes për këto pretendime, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë[1], nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipë-risë". Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organi-zimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendosi refuzimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE**,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipë-risë, në mbështetje të neneve 131/f, 134/1/g dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organi-zimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

[1] Votuan për pranimin gjyqtarët: B. Dedja, G. Dizdari, B. Imeraj dhe F. Lulo. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: V. Kristo, S. Berberi, V. Tusha dhe F. Hoxha.